

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1420 Prot.

Tiranë, më 12/03 /2020

URDHËR

Nr. 164, datë 12.03 .2020

“PËR

**MBYLLJEN E BAREVE, RESTORANTEVE, LOKALEVE, FAST FOOD DHE
KUFIZIMIN E SHËRBIMEVE QË OFROHEN NGA STRUKTURAT
AKOMODUESE QË OFROJNË SHËRBIM PËR KLIENTËT**

Në zbatim të nenit 7, pika 4 të ligjit Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si dhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e bareve, restoranteve, fast food, lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët, në të gjithë vendin, deri në datën 3.04.2020.
2. Përrjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 bëhet vetëm për shërbimin në banesë (delivery), i cili duhet të kryhet duke respektuar rregullat higjienike të miratuara.
3. Përdorimi i shërbimeve të bareve dhe restoranteve në strukturat akomoduese vetëm për qytetarët e akomoduar në strukturën akomoduese përkatëse, deri në datën 3.04.2020.
4. Strukturat akomoduese ndalohen të ofrojnë shërbim bar dhe restorant për qytetarë që nuk janë klientë të stukturës akodomuese, deri në datën 3.04.2020.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri.
6. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e Urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

